



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 218/5 Prot.

Tiranë, më 30.04.2025

V E N D I M

Nr. 101, Datë 30.04.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 21, datë 30.01.2025¹, e z. H.L kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Drejtoria Rajonale Fier, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “moshës²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Para vitit 2013 ndërtova një godinë me leje ndërtimi të rregullt (hipotekë) me qëllim që ta shfrytëzoja si biznes, por nuk e shfrytëzoja asnjëherë si biznes, nuk ka as NIPT dhe as një të dhënë që vërteton që është biznes.

Si rrjedhojë e mosshfrytëzimit si biznes është bërë pezullim i përkohshëm i kontratës³ me OSHEE, sipas proceverbalit bashkëlidhur këtij dokumenti më datë 15.02.2013.

Sipas librezës do të shikoni se, që pas pezullimit nëpërmjet procesverbalit të sipërcituar, filluan të më faturojnë tarifën prej 340 lekë të reja (tarifë shërbimi) dhe me vlera të tjera të ndryshme.

¹ Ankesa është plotësuar me informacionin e dërguar me email-in datë 18.02.2025.

² Ankuesi ka lindur në datë 05.04.1944 dhe është pensionist.

³ Kodi i Klientit: FI1F140031122550, Kabina 6 Ballsh MK 0091.

Kjo më detyroi të bëj ankimim online më datë 12.10.2015 dhe pavarësisht ankimit kam paguar deri në janar 2016 (libreza bashkëlidhur).

I jam drejtuar sërish me kërkesë-ankesë me datë 16.08.2017, sipas së cilës kundërshtova tarifën e shërbimit për periudhën shkurt 2016-korrik 2017, si rrjedhojë e kërkesës së bërë për pezullim të kontratës me datë 12.10.2015, kërkesë e realizuar në objekt, por jo në sistem.

Deri në vitin 2016 u paguan sa ishin për të paguar dhe u ndërpre edhe energjia elektrike.

Që nga viti 2016 deri më gusht të vitit 2024, unë nuk kam qenë në dijeni, nuk më është komunikuar që tarifa vazhonte, por energji nuk kishte në objekt. Për këtë fakt u vura në dijeni kur shkova në Ballsh te operatori elektrik për të kërkuar rilidhjen e kontratës dhe energjisë elektrike, ku operatori më komunikoi verbalisht dhe hapi sistemin ku figuroja debitor afërsisht 47.000 mijë lekë. Pas kësaj u paraqita pranë OSHEE Fier ku u ankova verbalisht dhe sipas punonjësës e cila më komunikoi po verbalisht që dërgoi ankesë me shkrim në Tiranë për sistemim të faturave.

Veprimi i fundit që kam bërë është me datë 27.09.2024 në OSHEE Fier ku përsëritet ankesa dhe sot më datë 18.02.2025, u praqita pranë OSHEE Fier, ku u vura në dijeni verbalisht që ankesa ime për sistemim faturash është në proces dhe ka mbetur te Drejtori i Divizionit Tregtar për të marrë aprovimin”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rregullimin e pasojave.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 218/1, datë 24.02.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar OSHEE, Drejtoria Rajonale Fier, për ankesën e bërë nga z. H.L, si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Shpjegime dhe kopje të dokumentacionit të historikut të veprimeve të OSHEE sha me ankuesin, lidhur me problematikën e shpjeguar nga z. L.
 - Kopje të procedurës së shqyrtimit të ankesës të bërë nga ankuesi në datë 27.09.2024 dhe të përgjigjes së dhënë.

- Informacion nëse ka pasur raste të tjera të njëjta apo të ngjashme me abonentë të tjerë dhe procedurat e ndjekura nga OSHEE sha, për zgjidhjen e tyre. Nëse ka, kopje të procedurave të ndjekura.

Me shkresën nr. 127/1, datë 10.03.202, OSHEE Drejtoria Rajonale Fier, informoi Komisionerin se: *“Z. H.L është paraqitur pranë kujdesit të klientit në datë 27.09.2024 dhe ka bërë Ankesë për Faturim (Billing Complaints). Nga ana e Drejtorisë Rajonale Fier është trajtuar me proces verbal dhe foto faktike në vend dhe dërguar për konfirmim dhe zgjidhje të problematikës pranë zyrës së Trajtimit të ankesave në Drejtorinë Qendrore Tiranë.*

Ju informojmë se jemi në pritje të përgjigjes dhe nuk ju paraqesim dot dokumentacion. Në momentin e trajtimit të ankesës atëherë do t'ju vihet në dispozicion relacioni i mbajtur dhe masat e marra”.

Me shkresën nr. 1931/1, datë 11.03.202, OSHEE sha, informoi Komisionerin se: *“Në vlerësim të kërkesës së ankuesit z. H.L nga strukturat përgjegjëse për menaxhimin e sistemit të faturimit janë marrë masat për kryerjen e verifikimit në terren të pretendimeve të paraqitura për kontratën FIIF140031122550.*

Në përfundim të procesit të sipërcituar është vendosur të kryhet sistemimi i faturimit për zbritjen e faturave nga muaji Prill 2018 e në vijim, si dhe ndryshimi i statusit të kontratës sipas kërkesës së z. L”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesi është kontaktuar nëpërmjet specialistes së Komisionerit pranë Zyrës Rajonale Fier dhe është njohur me përgjigjet e OSHEE sh.a dhe OSHEE Drejtoria Rajonale Fier.

Pasi është njohur me qëndrimin e OSHEE sh.a, ankuesi H.L, nëpërmjet Deklaratës datë 14.04.2025, është tërhequr nga ankesa e bërë pranë KMD-së, pasi ka vlerësuar masat e marra nga OSHEE sh.a, për ndryshimin e statusit të kontratës së furnizimit me energji elektrike.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet përfundimi i procedurës administrative: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i cili parashikon se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, dhe nenet 32 e 33, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 21, datë 30.01.2025, të z. H.L, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin ka filluar procedura administrative.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA